

Diana Sejdiu Shala është Profesor Asistent në UBT Higher Education, ku ligjeron Hyrje në Sociologji dhe Psikologji e Edukimit. Ajo ka më shumë se dy dekada përvojë në insitucionet arsimore dhe akademike në Kosovë, si mësuese, mentore e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtore e jashtme e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Ka përfunduar Doktoraturën në Organizimin dhe Menaxhimin e Proceseve të Informacionit në University of Library Studies and Information Technologies në Sofia, Bullgari, si dhe studimet Master në Sociologji. Diana zotëron edhe diplomë Bachelor në Edukimin Parashkollor dhe në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe nga Universiteti i Prishtinës.

Fusha e saj e studimit përfshin tema si: motivimi në mësimnxënie, performanca akademike, marrëdhënia mësues-nxënës, përgjegjësia sociale, lidërshipi dhe komunikimi. Ndër të tjera, Diana është autore e disa librave, “Përtej yjeve” dhe “Mbi Motivimin në Mësimdhënie” dhe ka botuar artikuj shkencorë në revista dhe konferenca ndërkombëtare.

Puna e Dianës pasqyron një përkushtim të gjatë në fushën e arsimimit dhe zhvillimit të praktikave për të ngritur cilësinë e arsimit dhe mësimdhënies në Kosovë.